



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Datë: 06.07.2026

Deçan


Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 17, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHTI, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Deçan shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT DHE INSTITUCIONIN E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP) PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

I. GJIMNAZI "VËLLEZËRIT FRASHËRI" NË DEÇAN

Drejtimi	Numri i paralave dhe nxënësve	Gjithsej nxënës
Shkenca Natyrore	5 x 25	125 nxënës
Shoqëroro - Gjuhësor	4 x 25	100 nxënës
GJITHSEJ	9 paralele	225 nxënës



II. INSTITUCIONI I ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP) "TAFIL KASUMAJ" NË DEÇAN

Drejtimi	Profili Arsimor	Numri i nxënësve
Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	Teknik i sistemeve të TIK-ut	1 x 24 = 24 nxënës
	Elektronikë	1 x 24 = 24 nxënës
Makineri, Prodhime dhe Ndërtimtari	Automekanik (Sistemi DUAL)	1 x 18 = 18 nxënës
	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1 x 22 = 22 nxënës
Ekonomi, Administrim dhe Juridik	Nëpunës i Kontabilitetit dhe tatimeve	1 x 20 = 20 nxënës
	Nëpunës i Marketingut dhe shitjes	1 x 18 = 18 nxënës
Agrokulturë, Pylltari, Peshkatari dhe Veterinari	Hortikulturë	1 x 18 = 18 nxënës
Shërbime	Asistent i mirëpritjes hoteliere	1 x 18 = 18 nxënës

Drejtimi	Profili Arsimor	Numri i nxënësve
	Kuzhinier	1 x 16 = 16 nxënës
Shëndeti dhe Mirëqenia	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	1 x 30 = 30 nxënës
GJITHSEJ	10 profile	208 nxënës

III. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE TË RREGULLT

1. Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të të Gjimnazit dhe të IAAP-së për vitin shkollor 2026/2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
2. Nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

IV. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR KONKURRIM

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron);
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (klasat 6-9);
- Certifikatën e lindjes.

V. AFATI I PARAQITJES SË DOKUMENTEVE DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

- **Paraqitja e dokumenteve:** Bëhet me datën **7, 8 dhe 9 korrik 2026** në lokalet e shkollës amë ku nxënësi dëshiron të regjistrohet, duke filluar nga ora **08:00 deri në 16:00**.
- **Shpallja e rezultateve:** Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **10.07.2026**.
- **Kthimi i dokumenteve:** Për nxënësit që nuk janë pranuar, kthimi i dokumenteve bëhet prej datës **11.07.2026**.

VI. PROCEDURA E ANKESAVE

1. Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditëve pune nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës.
2. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda dy (2) ditëve pune pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.
3. **Vërejtje:** Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar në shkollën përkatëse nënkupton humbjen e të drejtës për ankesë në shkallën e dytë në DKA apo në MASHTI. DKA dhe MASHTI nuk shqyrtojnë asnjë ankesë nëse ajo nuk është shqyrtuar fillimisht nga komisioni përkatës i shkollës.

VII. KRITERET PËR REGJISTRIM

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të kritereve të mëposhtme:

Nr.	Kriteri	Përqindja / Pikët
1	Suksesi nga shkollimi i obliguar	40% (40 pikë)
2	Suksesi nga lëndët me prioritet në test	20% (20 pikë)
3	Numri i pikëve nga testi i arritshmërisë	40% (40 pikë)
	GJITHSEJ	100% (100 pikë)

Nxënësi maksimalisht mund të fitojë 100% të pikëve.

Drejtori i DKA-së:

Besnik Hula

